



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

RAPORT SPECIAL

TEMATIKA: Publikimi i vendimeve të këshillave bashkiakë

(version i shkurtuar per web)

Publikimi i vendimeve të këshillit bashkiak është një detyrim që buron nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” dhe gjithashtu nga ligji organik 139/2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vendore”. Ne prill 2017, ne kuader te nismes “Monitorimi i ligjeve te transparences, mbeshtetur nga Leviz Albania, INFOCIP ndërmori vlerësimin e dytë të posaçëm në bashkinë Tiranë, Kamës dhe Vorë për publikimin e vendimeve të këshillit bashkiak.

Nga vlerësimi i ndërmarrë , rezulton se të treja bashkitë, Tiranë Kamëz dhe Vorë kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare ne internet vendimet e keshillave bashkiakë respektivë. Përveç Tiranës, dy bashkitë e tjera Kamza dhe Vora janë asistuar nga INFOCIP për të përmbushur këtë detyrim ligjor duke iu vënë në dispozicion platformën kombëtare VENDIME.AL, e cila është i integruar në faqe dhe përditësohet rregullisht.

Bashkia Tiranë

Bashkia Tirane ka patur nje sistem konsistent deri ne vitin 2011 te publikimit te vendimeve të këshillit bashkiak. Deri ne vitin 2015 konsistenca erdhi në rënie deri në momentin kur në faqen zyrtare nuk publikoheshin më vendime. Deri në shkurt të vitit 2016, ende nuk kishte një rikuperim të kënaqshëm të vakumit që ishte krijuar në këtë drejtim. Në monitorimin kombëtar të ndërmarrë nga INFOCIP për të drejtën e informimit në 61 bashkitë e reja të krijuara pas RAT, bërë publik në 3 Maj 2016, Bashkia Tiranë arriti të grumbullonte “0” pikë nga “2” të mundshme të takon publikimit online të vendimevetë këshillit bashkiak. Situata problematike u njoh nga administrata e Këshillit / Bashkisë. Publikimi i vendimeve të këshillit bashkiak u rikuperua me ritëm të kënaqshëm në Janar 2017, por gjithsesi me disa ndërprerje në vargun indeksues.

Në vlerësimin e muajit Prill 2017, INFOCIP depozitoi kërkesë për informim për të disponuar vendimet e këshillit bashkiak që mungonin. Kjo kërkesë, u protokollua konform rregullave dhe, në përgjigje të saj, u morën vendimet e munguara. Këto vendime, janë tashmë të publikuara në databazën kombëtare VENDIME.AL. Bashkia Tiranë gjithashtu është vënë në dijeni të mungesave te konstatuara dhe pritjet plotësimi i vargut indeksues në faqen zyrtare të saj prej vetë stafit të bashkisë.

Bashkia Kamëz

Bashkia Kamëz nuk ka patur një sistem koherent të publikimit të vendimeve deri në Gusht 2016. Në kuadër të ndërveprimit me aktore të shoqërisë civile, Bashkia Kamëz pranoi të bëhej pjesë e programit Kombëtar të publikimit online të vendimeve përmes platformës VENDIME.AL. Nga ky moment, vendimet janë publikuar me rregullsi dhe në varg të pandërprerë indeksues, sipas vitit kalendarik.

Vendimet e këshillit bashkiak Kamëz procesohen për botim me vonesë, pasi ato kthehen nga Prefekti, pothuajse me një ritëm sitematik. Kjo ka detyruar këshillit Bashkiak të mbledhet shpesh dy herë në muaj për të riakluar vendimet e kthyer nga Prefekti. Vlen të theksohet se një fenomen i tillë, i kthimit frekuent të VKB për ri-votim haset rrallë dhe nuk është një praktikë për t'u lavdëruar. Në asnjë rast pas ri-votimit të vendimeve, prefekti nuk ka inicuar veprime të mëtejshme gjyqësore, sikurse e parashikon ligji. Nga an tjetër, bashkia Kamëz ka paditur në Gjykatë Administrative Prefektin e Tiranës, për shkaqet e paraqitura më sipër.




Bashkia Vorë

Sa i takon Bashkisë Vorë, vendimet e këshillit bashkiak janë të publikuara online përmes Platformës Kombëtare VENDIME.AL. Baneri është i pozicionuar dukshëm në faqen e parë të eëbsiti-it zyrtar. Deri në datë 29 Shkurt, vendimet e këshillit bashkiak kanë qenë të pa-publikuara në faqen e internetit. Disponimi i tyre realizohej përmes zyrës së informacionit në bashki. Nga vlerësimi i realizuar në terren, rezultoi se nga stafi IT i bashkisë ishin bërë përpjekje për t'i publikuar vendimet në faqen zyrtare, por kjo kishte rezultuar e vështirë për shkak të një protokollit teknik të komplikuar që faqja zyrtare e Bashkisë Vorë ka në hedhjen e materialeve (realizuar dhe aktualisht pjesërisht në admisnitrim nga palë të treta).

Në datë 20/4/2017, INFOCIP depozitoi pranë bashkisë Vorë kërkesë për informim, bazuar në ligjin 119/2014 për të disponuar vendimet e këshillit bashkiak që nga momenti i konstituimit të këshillit të ri, pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015. Kjo kërkesë u plotësua në kohë nga Bashkia. Me marrjen e serisë vjetore të vendimeve, INFOCIP i procesoi ato në platformën kombëtare VENDIME.AL. Duke njohur edhe vështirësinë teknike të hedhjes së tyre në faqen zyrtare të kësaj bashkia, INFOCIP ftoi bashkinë Vorë të përdorte këtë sistem për përmblyshjen e detyrimit ligjor për të publikuar vendimet online, kërkesë e cila u pranua me kënaqësi. Aktualisht, të gjitha vendimet e reja procesohen normalisht për publikim online, edhe në mënyrë të decentralizuar. Aktualisht baneri është i pozicionuar në faqen e parë të eëbit zyrtar të bashkisë.

INFOCIP ka vënë në dispozicion të personit përgjegjës për publikimin e vendimeve infrastrukturen e nevojshme për të hedhur online në mënyrë autonome vendimet e reja që do të nxjerren nga këshilli bashkiak. Gjatë muajit Maj 2017 do të bëhet një rivlerësim i konsistencës dhe kapaciteteve për të hedhjen e vendimeve të mbledhjes së Prillit 2017.

METODOLOGJIA – Evidenca dhe Tabela e Vleresimit

Bashkia Tirane	Bashia Kamëz	Bashkia Vorë.
		
		
Pikë 2	Pikë 2	Pikë 2

Shpjegimi i pikëve/ tabela e vlerësimit

Bashkia nuk publikon vendimet e keshillit bashkiak, ose i publikon ato vetëm si tituj, pa tekstin e aktit	Bashkia publikon një pjesë të VKB, por vargu indeksues ka thyerje të shpeshta (mbi 30%)	Bashkia publikon të gjitha vendimet në faqen zyrtare, me të gjitha atributet e aktit dhe në varg të rregullt indeksues.
0 pikë	1 pikë	2 pikë